

DREJTIMI MËSIMOR
“HOTELERI TURIZËM”

KLASA
10

SHËRBIME PASTRIMI

Material mësimor për modulin
e praktikës profesionale të detyruar





NIVELI I

KLASA 10

DREJTIMI MËSIMOR
“HOTELERI TURIZËM”

Moduli

SHËRBIME PASTRIMI 1

**Material mësimor për modulin
e praktikës profesionale të detyruar**

M-13-1351-17
36 orë mësimore

Drejtimi mësimor: “Hoteleri Turizëm”

Moduli: Shërbime pastrimi 1

Material mësimor për modulin e praktikës profesionale të detyruar

M-13-1351-17 | 36 orë mësimore

Përgatiti: **Alma Biti, Anila Gjinari**

Trajnoi dhe moderoi procesin e hartimit të materialeve mësimore: **Dr. Mirela Andoni**

Redaktore letrare: **Tea Sadiku**

Paraqitja grafike dhe faqosja: **Fatbardha Rama**

Printimi i botimit: **Optima Communication**

Botimi i parë: **Gusht, 2019**

Literatura:

www.l’hotellerierestauraton.fr

Le metier de femme de chambre.

Nettoyage d’une chambre d’hotel

Laundry proces

The laundry cycle

House keeping laundry

Laundry equipment

Les detergents dans une laverie de l’hotel

Copyright: KulturKontakt Austria

Ky material është hartuar në kuadër të projektit ALTOUR: MBËSHTETJA PËR AKSES DHE CILËSI NË ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL PËR SEKTORIN E TURIZMIT, i financuar nga: Austrian Development Cooperation (ADC), me bashkëfinancim nga KulturKontakt Austria (KKA) dhe i zbatuar nga KulturKontakt Austria në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe partner lokal: Partnerë për fëmijët (PPF).

Në përputhje me synimet e projektit të implementuar nga KulturKontakt Austria, materialet e këtij botimi mund të përdoren vetëm në mësim dhe për qëllime jokomerciale.

Adresa: KulturKontakt Austria, Regional Project Office Tirana, Rruga Naim Frashëri, 37, Tirana

Të dashur mësues, nxënës dhe lexues,

Këtë vit, KulturKontakt Austria feston përvjetorin e saj të 30-të dhe vitin e 25-të të bashkëpunimit me sektorët e arsimit profesional dhe arsimit të përgjithshëm në Shqipëri!

Turizmi ka qenë një nga fushat e përbashkëta të bashkëpunimit që në fillim. Në Shqipëri dhe Austri, trashëgimia e pasur kulturore dhe peizazhet e bukura e të larmishme janë themeli për zhvillimin e suksesshëm të sektorëve tanë të turizmit. Megjithatë, një faktor po aq i rëndësishëm suksesi janë edhe njerëzit e mirëtrajnuar, të orientuar drejt shërbimit dhe sipërmarrjes, që punojnë në sektorin e turizmit, të cilët i bëjnë turistët të ndihen të mirëpritur dhe sigurojnë produkte dhe shërbime cilësore e të qëndrueshme.

Për sektorin e AF-së në fushën e turizmit, mikpritjes dhe furnizimit me ushqim, kjo nënkupton përditësimin e vazhdueshëm të programeve mësimore, për të reflektuar njohuritë dhe aftësitë që nevojiten me të vërtetë në tregun e punës. Përmes zhvillimit profesional, mësimdhënësit duhet të mbështeten për organizimin e procesit mësimor të orientuar drejt praktikës, i cili i ndihmon nxënësit për përfitim të kompetencave të nevojshme profesionale. Duhet krijuar dhe duhet zhvilluar formate të reja për bashkëpunimin me sektorin privat. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, procesi mësimor duhet të mbështetet nga materialet e duhura mësimore.

Projekti Al-Tour: “Mbështetja e cilësisë dhe qasja tek arsimi dhe formimi në fushën e turizmit në Shqipëri” po mbështet reformën në sektorin e arsimit dhe formimit në fushën e turizmit në këtë vend. Edhe materiali mësimor në dispozicion është përgatitur në kuadër të këtij projekti.

Materiali ju ofron udhëzime dhe ide se si të fitoni njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për të nisur një karrierë të suksesshme në sektorin e turizmit, mikpritjes dhe furnizimit me ushqim në profesionin që keni zgjedhur.

Dëshiroj t’u uroj suksese të gjithë përdoruesve të këtij materiali në realizimin e detyrës së tyre shumë të rëndësishme: krijimi i mundësive për sektorin e turizmit dhe mikpritjes në Shqipëri për të zhvilluar potencialin e tij të plotë dhe për shumë të rinj për gjetjen e shtigjeve sa më interesante në karrierën e tyre.

Dua ta shfrytëzoj këtë mundësi për të falënderuar partnerët tanë të projektit, Ministrinë Shqiptare të Financave dhe Ekonomisë, Agjencinë e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, bashkitë dhe konviktet në Korçë, Sarandë dhe Tiranë, shkollat tona partnere dhe organizatën partnere lokale “Partnerë për Fëmijët” (PPF) për bashkëpunimin e tyre të shkëlqyer. Falënderimet e mia të veçanta shkojnë për Agjencinë Austriake për Zhvillim, nga e cila financohet ky projekt.

Jakob Calice

Drejtor i KulturKontakt Austria

PËRMBAJTJA

RM1 Nxënësi/ja përdor mjetet, pajisjet dhe detergjentët në lavanderi	6
1.1 Veshja e uniformës në vendin e punës	7
1.1.1 Lavanderia	7
1.1.2 Kategoritë e lavanderive	8
1.2 Respektimi i standardit të profesionit	9
1.2.1 Personeli i lavanderisë	9
1.2.1 Proceset e punës në lavanderi	10
1.3 Sistemimi sipas rregullit i vendit për mbajtjen e detergjentëve	13
1.4 Përdorimi i makinerive larëse sipas manualit	14
1.5 Përdorimi i makinave tharëse sipas manualit	15
1.6 Përdorimi i hekurit të dorës sipas manualit	16
1.7 Përdorimi i rrulit hekurosës sipas manualit	17
1.8 Përdorimi i makinerisë për dezinfektim sipas standardit dhe dezinfektimi gjatë procesit të larjes	18
1.9 Përdorimi i detergjentëve larës sipas funksionit (fortësisë të detergjentit)	19
1.10 Përdorimi i detergjentëve larës sipas ngjyrës dhe përbërjes së materialit	19
1.10.1 Llojet e detergjentëve	19
1.10.1 Detergjente për rrobat me ngjyra	19
1.11 Përdorimi i solucionëve për heqjen e njollave	20
1.12 Përcaktimi i dozimit të detergjenteve sipas llojit, peshës dhe shkallës së pastërtisë së rrobave	20
1.12.1 Fletët e të dhënave të produkteve	20
1.12.2 Dozimi	20
1.13 Zbatimi i rregullave të higjienës, i mbrojtjes në punë dhe i ruajtjes së mjedisit në vendin e punës	21
1.13.1 Si i klasifikojmë rreziqet në punë?	21
1.13.2 Cilat janë rreziqet?	22
 RM2 Nxënësi/ja kryen proceset parapërgatitore për pastrimin e tualetit dhe dhomës në hotel	 24
2.1 Veshja e uniformës në vendin e punës	25
2.1.1 Punonjësi/ja i pastrimit	25
2.1.2 Roli i punonjësit të pastrimit në dhoma	25
2.1.3 Mënyra për tu bërë punonjës/e pastrimi për hotelet	26
2.1.4 Karriera dhe mundësitë e përmirësimit	27
2.1.5 Trajnimet e nevojshme	27
2.2 Përzgjedhja e mjeteve të nevojshme të punës për shërbimin e pastrimit në dhomë	27
2.3 Përgatitja e karrocës së pastrimit sipas planit të higjienës (pastrimit të dhomave)	29
2.3.1 Sistemimi në karrocë i solucionëve të pastrimit, furçave, leckave të pastrimit sipas rregullit	29
2.3.2 Vendosja dhe sistemimi i mjeteve të pastrimit në karrocën e shërbimit	29

2.4 Përzgjedhja e solucionet të pastrimit sipas standardit	30
2.4.1 Produktet e larjes	30
2.4.2 Hollimi produkteve të pastrimit	30
2.5 Sistemimi në karrocë i solucionëve të pastrimit, furçave, leckave të pastrimit sipas rregullit	31
2.6 Sistemimi i biankerisë së pastër sipas rregullit	31
2.7 Vendosja e qeses për biankerinë e përdorur sipas rregullit	32
2.8 Sistemimi i artikujve të përdorimit (setit personal) të klientit sipas rregullit	32
2.8.1 Produktet e mikpritjes	32
2.8.2 Tabakaja aristokrate	33
2.8.3 Qëllimi i setit personal	34
2.9 Sistemimi i materialeve informative për klientin sipas rregullit	34
2.10 Përgatitja për përdorim e fshesës me korrent	35
2.11 Zbatimi i planit të pastrimit të dhomave	35
2.12 Zbatimi i rregullave të higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në vendin e punës	36
 RM3 Nxënësi/ja pastron tualetin dhe dhomën e hotelit	 38
3.1 Veshja dhe uniforma në vendin e punës	39
3.2 Pastrimi i tualetit në dhomën e hotelit	39
3.2.1 Puna përgatitore	39
3.2.2 Pastrimi i banjës dhe vaskës	40
3.2.3 Kontrolli i funksionimit të pajisjeve dhe kompletimi me materiale sipas inventarit	42
3.3 Pastrimi i dhomës së hotelit sipas radhës së punës dhe proceset përkatëse	43
3.3.1 Verifikimi i gjendjes së dhomave të hotelit	43
3.3.2 Procedurat dhe kërkesat për mirëmbajtjen e dhomave të hotelit	44
3.4 Pastrimi i dhomave të hotelit	44
3.4.1 Hyrja në dhomë	44
3.4.2 Trajtimi i objekteve private	44
3.4.3 Radha ndjekëse e pastrimit të dhomave	44
3.4.4 Sistemimi i dhomave të hotelit	45
3.5 Rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në vendin e punës	46
 RM4 Nxënësi/ja pastron mjediset e përbashkëta të hotelit	 50
4.1 Veshja dhe uniforma në vendin e punës	52
4.2 Përgatitja e mjeteve të punës për pastrimin e mjediseve të përbashkëta sipas rregullit	53
4.2.1 Vendosja e tabelave të mbrojtjes ndaj aksidentëve, incidentëve në mjediset e përbashkëta	53
4.3 Pastrimi dhe dezinfektimi i tualeteve dhe mjediseve të hotelit në çdo moment të ditës	54
4.4 Pastrimi sipas rregullit në zyrat e administratës	54
4.5 Rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në vendin e punës	54

REZULTATI MËSIMOR NR.1

NXËNËSI/JA PËRDOR MJETET, PAJISJET DHE DETERGJENTËT NË LAVANDERI



1.1 Veshja e uniformës në vendin e punës

Punonjësi i lavanderisë sapo arrin në hotel, shkon në dhomën e posaçme të veshjes dhe vesh uniformën dhe këpucët mbrojtëse për të filluar punën. Uniforma duhet të jetë e pastër, e hekurosur dhe e mirëmbajtur.

Uniforma është e ndryshme nga ajo e departamenteve të tjera të hotelit, ka logon e hotelit dhe emrin i punonjësit.



1.1.1 Lavanderia

Lavanderia është një nga departamentet të një rëndësie të vecantë në hotel e cila klasifikohet si një nga shërbimet prioritare të hotelit. Në mënyrë figurative, ai është heroi i sektorit të shërbimit të dhomës i cili do të kujtohet nga klienti: një prekje e butë dhe e këndshme e të linjtave të dhomës kur të kthehen në dhomë pas një dite të lodhshme apo pas një mbledhje të gjatë biznesi.

Lavanderia është departament i cili varet nga departamenti i shërbimit të dhomave. Menaxheri i lavanderisë duhet të raportojë tek menaxheri ekzekutiv i shërbimit të dhomave. Në hotelet e vogla personeli i shërbimit të dhomave kujdeset edhe për lavanderinë e hotelit.



Departamenti i lavanderisë menaxhon:

Të linjtat e hotelit:

- peshqirë të ftyrës, duarve, trupit;
- të linjtat e krevatit si këllëfë, çarçafë, mbrojtëse dysheku;
- robëdishamë për pishina;
- të linjtat e restorantit si mbulesa, mesore, piceta.

Uniformat e personelit:

Larja e uniformave bëhet me kujdes, sipas departamenteve, ngjyrave, shkallës së papastërtisë dhe e veçantë nga të linjtat e hotelit.

Veshjet personale të klientëve.

Në dhomën e hotelit në përgjithësi, në një nga raftet e dollapit, vendoset një çantë për lavanderinë. Nëse klienti ka nevojë për larje të veshjeve personale duhet ti referohet formularit të tarifave , kushteve dhe termave për larjen e tyre, më pas plotësohet formulari. Pasi të linjtat e hotelit ose të klientit të jenë larë ato shpërndahen sipas dhomave të klientit dhe klienti duhet të firmosë një faturë, vlera e së cilës përfshihet në faturën përfundimtare të klientit.

Inventarin e të linjtave.

Punonjësi i lavandisë i ngarkuar me marrjen e të linjtave bën regjistrimin në regjistrin e lavanderisë për të gjithë inventarin e të linjtave që hyjnë e dalin nga lavanderia.

Parimi kryesor i lavanderisë është:

- të heqë çdo papastërtitë dhe njollat nga çdo artikull i të linjtave;
- të kthejë të linjtat në të njëjtën pamje si më parë.

Lavanderia është cilësore kur:

- larja e të linjtave bëhet me kujdes;
- përzgjidhet procesi duhur për detergjentin e përzgjedhur;
- të linjtat e bardha mbeten të tilla , pa përdorur zbardhues;
- të përlogartet dhe të mbahet shënim për të mënjauar shkurtimin e kohës së pëdrimit të të linjtave.

1.1.2 Kategoritë e lavanderive

Në industrinë e hoteleve njihen dy kategori të lavanderive:

1. Hoteli nuk ka shërbim lavanderie.

Anët pozitive:

- kursim në blerje të makinerive e pajisjeve të lavanderisë;
- kursim në paga të punonjësve;
- ambientet e hotelit mund të përdoren për shërbime të tjera.

Anët negative:

- përballje e hotelit me cilësinë e larjes;
- mundësia të larta vjedhjeje;
- mungesë e të linjtave të hotelit në raste emergjente.

2. Hoteli ka shërbim lavanderie.**Anët pozitive:**

- zvogëlohet koha e larjes pasi nuk ka transport;
- në rast emergjence të linjat janë në hotel;
- vjedhjet e inventarit zvogëlohen.

Anët negative:

- kosto e lartë e blerjes së pajisjeve dhe mirëmbajtjes së tyre;
- kërkim i inventareve të linjtave;
- kërkohet hapësirë e mjaftueshme dhe personel i kualifikuar.

1.2 Respektimi i standardit të profesionit

1.2.1 Personeli i lavanderisë

Lavanderia drejtohet nga menaxheri i lavanderisë ose përgjegjësi i lavanderisë i cili ndihmohet nga:

Korrieri - i cili merren me marrjen dhe shpërndarjen e teshave të klientit të hotelit.

Ndarësit dhe shënuesit - të cilët merren me ndarjen, klasifikim dhe shënimin e artikujve të lavanderisë.

Magazineri - i cili kujdeset për inventarin e artikujve të lavanderisë.

Punëtorët e larjes - të cilët janë përgjegjës për larjen dhe tharjen.

Punëtorë të hekurosjes - të cilët bëjnë hekurosjen në makineritë sheshta.

Punëtorë të hekurosjes me avull - të cilët bëjnë hekurosjen me pajisjet me avull.

Punëtorë të pastrimit kimik - të cilët merren me heqjen e njollave dhe pastrimin kimik.


Rrobaqepësi - të cilët merren me riparimet e uniformave të hotelit dhe veshjet e klientëve.



1.2.1 Proceset e punës në lavanderi

Mbledhja dhe transportimi:

- Mblidhni të linjtat në ambientet e caktuara nëse hoteli nuk ka shërbimin lavanderi dhe në ambientet e lavanderisë nëse ka lavanderi.
- Transporti i brendshëm bëhet me karroca apo thasë pëlhere.
- Transporti i jashtëm bëhet me mjete transporti sipas kontratave të shërbimit të lavanderisë.



Ndarja dhe shënimi:

- Ndahen produktet sipas klasifikimit në listën e lavanderisë.
- Llogaritet numrin për çdo grup ndarje të produkteve.
- Përcaktohen mungesat.
- Shkruhet numri i produkteve në listën e lavanderisë.
- Lexohet me kujdes udhëzuesi i larjes së produkteve.
- Kontrollonhet çdo veshje për dëmtime ngjyrosje, njolla, kopsa të këputura, grisje etj.
- Raportohet çdo kusht të pazakontë, si gjetjen e materialeve me vlerë në produktet e lavanderisë.
- Menaxheri ose personi i caktuar kujdeset për produktet që duhen riparuar si , grisjet, kopsat e këputura etj.
- Ndahen produktet që do të lahen në makineritë larëse nga që do të lahen me dorë duke iu referuar materialit dhe ngjyrës.
- Ndahen produktet që do të lahen me makineri apo në pastrim kimik.

Larja:

- Duhet të tregohet kujdes që mos dëmtohen gjatë larjes dhe mos të tejmbushet makina larëse.
- Duhet të ndahen produktet sipas ngjyrës, llojit të materialit dhe instruksionit të larjes.
- Kontrollohen xhepat dhe dëmtimet për rrobat e stafit dhe klientëve. Uniformat që janë shumë të ndotura kanë nevojë të trajtohen kimikisht përpara larjes normale.
- Personeli i ngarkuar me procesin e larjes është përgjegjës edhe për pastrimin e makinerive në fund të ditës.

Hekurosja:

- Duhet të bëhet me makineri të posaçme si hekurosja me rul, me avull etj.
- Palosni sipas rregullit.
- Dërgojini në ambientin e paketimit.
- Hekurosini me dorë e të gjithë produkteve që nuk janë proceduar me makineri.
- Raportoni tek përgjegjësi çdo kusht jo normal i produktit si mungesa e kopsave, dekolorimi, kontaminimi nga ngjyrat etj.
- Kontrolloni punën e bërë para se produktet të shkojnë në ambientet e paketimit.

Ndarja:

- Ndani rrobat sipas numrit të dhomës duke iu referuar listës origjinale të lavanderisë.
- Bëni kontrollin përfundimtar të standardit të larjes dhe hekurosjes.
- Hiqni shënimi i numrit nga rrobat.
- Vendosni rrobat në ndarje të veçanta dhe i bashkëngjitet etiketa treguese.
- Gruponi rrobat të cilat duhen të dërgohen në varëse sipas listës origjinale të lavanderisë.
- Vendosni shënim në varëse për çdo paketim për të evidentuar numrin e dhomës ku do të dërgohet.

Palosja:

- Kontrolloni edhe njëherë për riparime apo kopsat veçanërisht.
- Palosni këmishat, me përjashtim kur ato kërkohen në varëse.
- Palosni me makineri që të siguron paraqitje më të mirë dhe të ruani cilësinë e hekurosjes.



Paketimi:

- Kontrolloni cilësinë e larjes, hekurosjes, presimit.
- Mblidhen sipas listës origjinale të lavanderisë rrobat dhe vendosini në paketim.
- Bëni paketimin në ambalazhe pëlhure ose plastike.
- Vendosni në mënyrë të dukshme etiketa e lavanderisë.

Procedura presimit:

- Produktet të cilat janë për tu presuar, bëhen në makineri të emërtuara presa dhe nga personi i caktuar.
- Përdorni shenjues të kuq për procedurën të presimit.
- Pas shënimit të numrit të dhomës në rrobe duhet të sigurohemi për shpërndarjen e shpejtë tek klienti.
- Kontrolli para se të dërgohet tek klienti.

Ajrosja: është shumë e domosdoshme pasi mbron të linjtat nga myku.



Magazinimi: të linjtat duhet të qëndrojnë në rafte për një periudhë kohe para se të shpërndahen. Kjo ndihmon në rritjen e jetëgjatësisë së të linjtave.

Shpërndarja: bëhet nga personeli i caktuar me këtë detyrë.

- Shpërndarja bëhet në orën 6⁰⁰ të pasdites të së njëjtës ditë nëse janë marrë para orës 12⁰⁰ të drekës dhe në 6⁰⁰ pasdite të ditës tjetër nëse rrobat janë marrë pas orës 12⁰⁰ të drekës.
- Mos njofto klientin nëse në derë është vendosur shënimi: “MOS SHQETËSO”.
- Rrobat në varëse vendosen në gardërobë dhe ato të paketuara mbi krevat në mënyrë të dukshme.
- Shpërndarja ekspres bëhet brenda 4 orëve nga marrja e rrobave të klienti dhe tarifimi është 100%.

1.3 Sistemimi sipas rregullit i vendit për mbajtjen e detergjentëve

Detergjentët duhet të ruhen në magazine të thata, të ventiluara dhe të mbyllura. Kontejnerët duhet të vendosen në mënyrë që të arrihet lartësia maksimale e punës gjatë procesit të mbushjes. Kur bëhet dekantimi është e rëndësishme t'i kushtohet vëmendje përdorimit të maskave kirurgjikale dhe dorashkave prej gome.

Sistemimi i detergjenteve duhet të bëhet në vendet e parashikuara sipas kategorive, e ajrosura në mënyrë korrekte dhe e mbyllur me çelës. Sasia e detergjenteve të grumbulluar do të jetë i limituar sipas periudhave të përcaktuara të përdorimit. Gjithashtu është e këshillueshme që sasia e produkteve që ruhen në magazinë të mos kalojnë limitin e nevojshëm dhe të mos ketë mbivendosje të produkteve në atelietë e punës në një ditë të zakonshme pune. Të gjitha këto gjëra marrin hapësirë. Ato duhet të jenë të rregulluara dhe lehtësisht të arritshme. Duhet gjithashtu të ketë hapësirë të mjaftueshme për të lëvizur.

Bëni kujdes që asnjë material ose produkt të mos lihet jashtë vendeve të autorizuar ose të mos braktisen pas përdorimit, por të sistemohen me kujdes në vendin e tyre dhe sipas radhës së përdorimit.



Klasifikimi, renditja dhe sistemimi i papërshtatshëm shkaktojnë dobësimin e ambalazhimit origjinal duke shkaktuar rrjedhje ose thyerje aksidentale, ndotje.

Në hotelet e mëdha, çdo kat ka dhomën e vet të magazinimit. Është në varësi të magazinës qendrore dhe përmban aq sa nevojiten për pastrimin dhe mirëmbajtjen e një kati në mënyrë që të anashkalohen furnizimet e panevojshme. Nuk duhet të shërbejë si sallon për punonjësit. Përgjegjësi për këtë sektor i jepet një punonjësi të katit. Mirëmbajtja e kësaj dhome-magazinë është tregues i menaxhimit të pastërtisë dhe atmosferës së punës në kat. Për këtë arsye këto ambiente janë të pajisura me lavaman dhe furnizim me ujë të ngrohtë dhe të ftohtë p.sh. për larjen e duarve. Dhoma duhet të jetë e ndritshme. Ndriçimi duhet të instalohet në mënyrë të tillë që kutitë dhe raftet të mund të shihen mirë. Mbulesa e dyshemesë duhet të jetë e lehtë për t'u pastruar dhe rezistente ndaj kimikateve të pastrimit.

Listat e kontrollit për verifikimin, pastrimin (udhëzimet e dozimit për kimikatet e pastrimit) dhe për mirëmbajtjen duhet të vendosen në një vend të qartë të lexueshëm, direkt në sistemet e dozimit ose pajisjet.

Rregullat e sigurisë, rregulloret në rast zjarri si dhe rregullat e sjelljes të kërkuara nga kompania duhet të vendosen në një vend të dukshëm. Meqenëse personat e paautorizuar nuk kanë qasje, duhet të sigurohet me një derë të mbyllur. Kujdes duhet të tregohet edhe për ambalazhet e detergjenteve. Trajtimi i tyre duhet të bëhet sipas shënimeve të veçanta në etiketën e produktit.

1.4 Përdorimi i makinerive larëse sipas manualit

Makineritë larëse

Përzgjedhja e makinave larëse dhe tharëse duhet të bëhet në bazë të sipërfaqeve të lavanderisë dhe kapacitetit të larjeve. P.sh. në lavanderi të vogla makinat e mëdha janë të vështira për tu menaxhuar, sepse punonjësja dhe detergjentët, dollapët e rrobave dhe shportat ose raftet duhet të kenë hapësirën e nevojshme për të punuar sa më mirë. Nëse kemi makina të vogla, mirë do të jetë të bëhen larje të shpeshta dhe jo ngjeshje të rrobave. Vëllimet e mëdha të mbushjes tentojnë të kufizojnë fleksibilitetin.



Makineria varet nga:

- kapaciteti që duhet të ofrohet;
- buxheti kohor për larje;
- numri i punonjësve;
- cilësia e biankerisë.

Sistemet moderne me performancë të lartë dhe programe të fuqishme të makinës kursejnë energji dhe ujë. Shfrytëzimi i makinave kontrollohet me një libër performance në të cilin regjistrohen mbushjet e makinës. Ky libër shërbimi është një ndihmë vendimi për investime të mëtejshme.

Performanca e fuqisë, e larjes dhe e shtrëngimit vlerësohet me rendimentin e efikasitetit të energjisë të Bashkimit Europian A-G. Me A përcaktohen pajisjet që kanë konsum më të ulët energjie dhe G me konsumin më të lartë. Për konsum më të ulët, si dhe për larjen më të mirë dhe efektin tharës qëndron A, për vlera më të ulëta gjatë larjes dhe tharjes qëndrojnë B dhe C.

Zgjedhja e modelit është shumë e gjerë. Pajisjet janë në dispozicion me një peshë mbushëse prej pesë deri në 30 kilogramë dhe për kazanë larës deri në 90 kg.

Gjithashtu kërkohet një trajnim intensiv dhe i vazhdueshëm i punonjësve. Me kontrolle elektronike, programet e larjes mund të përshtaten me llojin e lavanderisë dhe shkallën e ndotjes. Pasi të futni numrin e programit, fillon procesi i dëshiruar i larjes. Kontrollat me shumë butona për përzgjedhjen e programeve kërkojnë njohuri të mira të punonjësve.

1.5 Përdorimi i makinave tharëse sipas manualit

Lavatriçet tharëse

Pesha që lejohet të mbushet makina tharëse ose centrifuga mund të jetë midis 10 dhe 30 kg. Gjatë instalimit të centrifugës, është e rëndësishme të sigurohet prania e një shkarkimi të nevojshëm për ujin e mbetur. Për ngarkimin dhe shkarkimin e rrobave përdoren kolona të përshtatshme në mënyrë që të mund të kalojë rroba e lagur, shumë e rëndë, pa përpjekje të panevojshme fizike në makinë tharëse. Të gjithë punonjësit duhet të trajnohen mirë për të siguruar përdorim të saktë. Paralajmërimet duhet të formulohen qartë dhe të jenë të dukshme.

Ekziston funksioni larës dhe tharës në të njëjtën makineri për përdorim optimal të hapësirës, kohës dhe makinerisë. Në këtë rast, rrobat e lara dhe të shkriëta mund të transferohen drejtpërdrejt në tharëse. Nëse pesha e kapacitetit tharës nuk korrespondon me atë të makinave larëse, punonjësi automatikisht duhet të zgjedhë ose të peshojë sasinë e duhur të biankerive për të larë. Nëse pesha potenciale e mbushjes nuk është shfrytëzuar, ndodhin humbje të energjisë. Nëse pajisjet tejmbushen, shkalla e dëshiruar e thatësisë nuk arrihet dhe biankeritë janë të rrudhura.

Makinat e disponueshme në treg kanë një kapacitet prej dhjetë deri në 30 kilogramë dhe tharësit për lavanderi të mëdha kanë kapacitet deri në 60 kilogramë. Kapaciteti maksimal i makinave duhet të respektohet. Nëse copa të mëdha dhe të vogla vendosen në mënyrë automatike në makinë kur mbushni makinën larëse, arrihet një sukses më i mirë i larjes. Për rrobat midis makinës larëse dhe tharëse ka kontejnerë plastikë me rrota të shënuara me dy ngjyra p.sh blu për larje.

Duhet pasur parasysh pasojat e tejmbushjes së makinave larëse dhe tharëse si:

- konsumimi pa kriter i energjisë;
- harxhim i detergjenteve;
- rrudha të paparashikuara;
- depërtim i lëngjeve larës në fibrat e rrobave;
- njolla të vështira për tu pastruar;
- shpëlarje e keqe;
- aromë e rëndë detergjenti;
- mbetjet e pastruesit dhe papastërtitë ngelen në kazanin e lavatriçes.

Këshilla:

- Kur ngarkoni lavatriçen për larje me rroba me lagështi të parapërgatitur, vetëm dy të tretat e sasisë së specifikuar të mbushjes mund të futen.
- Mbushja me peshqirë duhet të jetë vetëm dy të tretat e peshës së ngarkesës.
- Makineritë në lavanderi kërkojnë mirëmbajtjen dhe kujdesin e ekspertëve.

Mbani mend: të linjtat e ndotura vendosen të ndara deri në grumbullimin dhe transferimin në lavanderi. Në kompanitë e mëdha ekziston një lavanderi, përmes së cilës, të linjtat e ndotura transportohen me kontenierë. Këto kontejnerë duhet të jenë sa më afër hyrjes së furnitorit ose lavanderisë gjatë operimit me qëllim që të shmangen rrugët e gjata të transporti

1.6 Përdorimi i hekurit të dorës sipas manualit

Në hotele përdoret edhe hekuri i dorës. Ai mund të jetë pjesë e inventarit të dhomave duke iu ofruar klientëve një lehtësi më shumë. Në lavanderi, hekuri i dorës përdoret kur rrobat nuk mund të hekurosen me makineri. Është e rëndësishme të tregohet kujdes për leximin e etiketave.

Etiketa përmban llojin e materiali dhe udhëzimet e lidhura me larjen dhe hekurosjen e pëlhurës.

Në to jepet shpjegimi për:

- materialin e përdorur në %;
- ena që tregon larjen me ujë dhe temperaturën në gradë;
- trekëndëshi që tregon mundësinë për tu larë ose jo me zbardhues;
- shenja e hekurit që tregon hekurosjen dhe temperaturën;
- drejtkëndëshi me rrethore brenda i cili tregon tharjen në makinën tharëse;
- shenja rrethore e cila tregon trajtim kimik;
- simbolet e kryqëzuara me një X, që tregojnë që ky trajtim nuk është i mundur.

Për të qenë e kompletuar, etiketa duhet të ketë informacione të dobishme për të mbrojtur edhe lëkurën tonë nga alergjitë e mundshme apo komponentët toksike. Për të zgjedhur pëlhura në përputhje me normën mund të verifikojmë se ku është prodhuar veshja

Disa këshilla:

- Rrobat prej pambuku: hekurosni në nxehtësi të lartë përderisa pëlhura është ende e lagësht në prekje. Përdorni butonin me avull sipas nevojës për spërkatje.
- Rrobat me material lino: hekurosni në nxehtësi derisa pëlhura është e lagur dhe përdorni sa më shumë opsionin e avullit për të mos u ngjitur hekuri me materialin.
- Rrobat e leshta: hekurosni nga prapa me nxehtësi mesatare apo të ulët si dhe përdorni butonin e avullit për t'i lagur rrobat sipas nevojës.
- Rrobat prej mëndafshi: hekurosni nga prapa në nxehtësi të ulët, dhe menjëherë pas larjes, deri sa janë akoma të lagësht – nuk keni nevojë për avull apo spërkatje shtesë me ujë. Nëse është e nevojshme përdorni edhe një leckë mbi rrobat gjatë hekurosjes, që të evitoni ngjitjen e mundshme.
- Rrobat poliestër: hekurosni me nxehtësi mesatare dhe të ulët përderisa janë akoma të lagësht. Spërkatni sipas nevojës, por shmangni avullimin. Avulli dhe nxehtësia e lartë mund të lënë shenja si shkëlqim plastik.
- Rrobat prej najloni: hekurosni me nxehtësi të ulët. Mos përdorni avullin, por spërkatni pak sipas nevojës herë pas here.
- Rrobat prej akrilik: hekurosni nga prapa me nxehtësi të ulët. Asnjëherë mos përdorni butonin e avullit, por spërkatni me ujë sipas nevojës.
- Rrobat me dantellë: hekurosni kur janë të thata plotësisht me nxehtësi të ulët si dhe vendosni ndonjë leckë sipër rrobave për mbrojtje. Mos përdorni avull apo spërkatje me ujë.
- Robra kadifeje: asnjëherë mos i hekurosni rroba me material të tillë.

1.7 Përdorimi i rulit hekurosës sipas manualit

Makina rul për hekurosje

Në varësi të sasisë dhe llojit të hekurosjes, ofrohen makina me diametër rrotullues deri në 120 cm dhe gjerësi pune deri në 300 cm. Një makinë gjithashtu mund të pajiset me disa rrula njëkohësisht. Rrulat mund të nxehen me elektricitet, me avull ose gaz. Këto modele mundësojnë që makina të operohet vetëm nga një punonjës dhe mund të vendosen në një mur për të kursyer hapësirë.



Të linjtat sigurojnë një hekurosje cilësore dhe pa rrudha. Janë makineri të kushtueshme dhe sigurohen zakonisht nga hotele me kapacitete të mëdha. Hekurosja e mirë dhe e shpejtë është e mundur nëse të linjtat kanë shkallën e duhur të lagështisë, merret parasysh dizajni i larjes dhe përzgjedhja e saktë e temperaturës.

Listë kontrolli

- kontrolloni lagështinë e hekurit;
- përcaktoni me dorë nëse rrobat janë të lagura;
- mbuloni të linjtat me një peshqir për të ruajtur lagështirën. Është e pafavorshme nëse janë tepër të thata.

Për ti spërkatur, mund të përdoren shishet me llak me një atomizues të mirë të mbushur me ujë të ngrohtë. Vetëm të linjtat e pastra mund të hekuroset, pasi papastërtia e mbetur gjatë hekurosjes mund të bëhet fort e lidhur me fibrat e pëlhurës dhe do të jetë më e vështirë për t'u hequr. Modelet e hekurosjes duhet të bashkëngjiten si një grafik i qartë. Trajnimi i mirë i punonjësve garanton punë të shpejtë dhe të saktë. Rreth dy të tretat e rrobave operative mund të përpunohen me makina për hekurosjen rul.

Pjesa tjetër hekuroset me hekurin e varur ose në tavolinat e hekurosjes. Hekuri pastrohet nga pluhuri me një pëlhurë pa fibra. Nëse është e nevojshme, shtohet një shtresë e hollë vaji për të rritur shpejtësinë e rrëshqitjes. Shpejtësia e rulit përcakton shpejtësinë e punës. Tabela e hekurosjes duhet të kontrollohet para fillimit të punës.

Për makinat hekurosëse duhet të kihen parasysh masat e sigurisë. Sigurimi i tabelave të hekurosjes duhet të jetë e vendosur në të njëjtin nivel. Puna e hekurosjes në thelb duhet të bëhet ulur, por edhe vendet e rregullta sipas standardit për hekurosjen në këmbë, lehtësojnë punën e punonjësit që kryen hekurosjen.

Hekurosja garanton transmetimin më të mirë të energjisë dhe ka një efekt pozitiv në shëndetin e të punësuarve dhe në rezultatet e punës.

1.8 Përdorimi i makinerisë për dezinfektim sipas standardit dhe dezinfektimi gjatë procesit të larjes

Dezinfektimi i makinës larëse dhe tharëse do të thotë mirëmbajtja dhe ruajtja nga erërat e këqija, mikrobet dhe myku. Investimi në këtë fushë është i domosdoshëm sepse makinat e mbajtura keq dhe të padezinfektuara përbëjnë rrezik, prishen shpejt, por mund të prishin peshqirët, mbulesat, pa harruar dhe veshjet e klientëve. Për këtë arsye, në magazinat e hoteleve gjenden gjithmonë produkte pastrues dhe dezinfektues si për makineritë ashtu edhe për procesin e larjes.

Këto janë:

- uthulla e bardhe e distiluar përdoret gjatë dhe pas larjes;
- acidi sitrik është dezinfektant natyral, i fuqishëm, eliminon kripërat, kalkaret dhe shkumën e sapunit;
- sodë + uthull përzierje që heq aromat e këqija dhe kripërat;
- hidrogjen peroxide përdoret me ujë të ngrohtë dhe heq kalkaret, mykun dhe bakteret.

Është më e sigurt të përdorni agjentët zbardhues me përmbajtje klori, sepse ata nuk lenë avuj, as mbetje toksike as në tekstile, as në makineri. Gjithashtu, janë të parrezikshëm për ambientin sepse shpërbëhen në oksigjen dhe ujë.



1.9 Përdorimi i detergjentëve larës sipas funksionit (fortësisë të detergjentit)

Informohuni me kujdes për përbërësit e detergjentit para se të vendosni për një produkt. Pislëku ka erë të keqe, ngjit dhe shkatërron fibrat. Uji bashkë me detergjentët e eliminojnë papastërtinë. Pothuajse një e katërta e ndotësve janë të thatë, gjë që shpjegon përse detergjentët dhe fërkimet mekanike janë të nevojshëm për ta eliminuar plotësisht pislëkun.

Detergjentët cilësor përmbushin shumë detyra:

- eliminojnë kripërat dhe kalciumet nga uji i ashpër;
- heqin njollat;
- papastërtia lidhet me detergjentin larës dhe shkëputet nga fibra;
- makineria mbrohet nga gërryerja;
- copat nuk dëmtohen nga produktet kimike.

1.10 Përdorimi i detergjentëve larës sipas ngjyrës dhe përbërjes së materialit

1.10.1 Llojet e detergjentëve

Më shumë se një pastrues nuk mund të përdoret. Kjo do të thotë se në çdo larje përbërësit e ndryshëm janë të tepërt, sepse nuk i përmbushin detyrat e pastrimit. Duhet të merret parasysh gjatë zgjedhjes së detergjentit përbërja e fibrave dhe etiketimi i kujdesit të tekstileve. Për më tepër, lloji i kontaminimit dhe shkalla e ndotjes janë gjithashtu vendimtare për zgjedhjen e detergjentit. Ofrohen detergjentë pluhur dhe të lëngshëm. Një njësi matëse tregon sasinë e kërkuar të detergjentit në makinën larëse.

Detergjentët e pastrimit janë quajtur detergjentë universal dhe i përshtaten të gjitha temperaturave të larjes. Rezultate shumë të mira janë marrë me larjen në temperatura të larta të larjes së tekstileve të bardha dhe lehtësisht të ngjyrosura. Detergjentët me aktivitet të fortë larës nuk përshtaten me fibrat e ndjeshme për arsye të lëndës së fortë alkaline. Agjentet shpesh që përmbajnë detergjentët e tipit të rëndë nuk kanë rezultate të mira në larje. Për këtë arsye pakësohet dukshëm përqendrimi i detergjentit duke ulur dozën e përdorimit për çdo larje ose hollimin me agentë hollues të veçantë për çdo detergjent.

1.10.1 Detergjente për rrobat me ngjyra

Ata përdoren për të larë tekstilet me ngjyrë. Krahësuar me detergjentët e fuqisë së plotë këtu nuk përdoren agjentë zbardhues dhe ndriçues optikë. Mbrojtja e ngjyrave ka për qëllim parandalimin e çngjyrosjes së grimcave të ngjyrosura. Kemi detergjentë në gjendje të lëngshme por edhe pluhur, për rroba me ngjyra të ndryshme por edhe tekstile të zeza.

1.11 Përdorimi i solucioneve për heqjen e njollave

Nëse pëlhura dhe stili e lejojnë, këshillohet, së pari, shpëlarja e njollës me ujë të ftohtë. Një leckë vendoset nën njollë. Detergjenti pastrues vendoset në një leckë pastrimi dhe fërkohet njolla nga brenda-jashtë, në një lëvizje rrethore dhe me presion të butë. Fërkim i rëndë e ashpëron pëlhurën. Nëse tretësi nuk e ka hequr tërësisht njollën, ajo duhet të hiqet plotësisht nga biankeria përpara se të përdorni ndonjë detergjent tjetër. Gjatë heqjes së njollës nuk duhet të pihet duhan. Rekomandohet ventilim i mirë në dhomë dhe ndoshta mbrojtja e rrugëve të frymëmarrjes.

1.12 Përcaktimi i dozimit të detergjenteve sipas llojit, peshës dhe shkallës së pastërtisë së rrobave

1.12.1 Fletët e të dhënave të produkteve

Fletët e të dhënave të produkteve përmbajnë informacion të plotë në lidhje me temperaturën e larjes, përbërjen e biankerive, dozën e përdorimit, peshën e rrobave, kohëzgjatjen e procesit larës etj.

Detyrë 1

Gjeni shembuj të udhëzimeve të përdorimit të produkteve larëse dhe përshkruaj llojin e informacionit.

Detyrë 2

Tekstualizoni fotot e mëposhtme dhe analizoni dozat e përdorimit të këtyre solucioneve.



1.12.2 Dozimi

Udhëzimet e dozimit për të gjithë kazanët e rrobave duhet të jenë të bashkangjitura shumë qartë në makina. Vlerat e dhëna nga prodhuesi duhet të kontrollohen paraprakisht. Gota e dozimit kanë një mililitër dhe një gramë gradimi. Ato duhet të përshtaten me kutinë e mbushjes së makinave larëse dhe duhet të bëhen prej materiali transparent dhe të qëndrueshëm. Mbidoza redukton fuqinë larëse të solucioneve, pasi zhvillimi i madh i aromës pengon tharjen e fibrave. Në rastin e mbidozimit, detergjenti është shpëlarë vetëm pjesërisht nga lavanderi, si rrjedhim në rrobat e bardha,

fibrat mund të dëmtohen. Mbetjet e detergjentit mund të shkaktojnë acarim të lëkurës. Përveç kësaj, grimcat me yndyrë që mbeten në pëlhurë ngjiten në pjesën e jashtme të kazanit, të cilat ndërhyjnë në larjen e ardhshme. Mund të jetë e nevojshme të bëhet një larje tjetër, e cila shkakton kosto. Doza e detergjentit varet nga makinat ekzistuese. Nëse një detergjent përputhet me të gjitha kërkesat dhe nëse llogaritja e çmimeve është e favorshme, sasia e detergjentit në kapacitetin ekzistues të magazinimit do të porositet në përputhje me rrethanat. Kërkesa javore regjistrohet.

Në sistemet automatike të dozimit, madhësia e enëve përputhet me kërkesën e llogaritur për një numër të caktuar të proceseve të larjes. Kontejnerët janë të lidhur direkt në stacionin e dozimit. Me një sistem dozimi plotësisht automatik, sigurohet sasia e kërkuar e detergjentit, në varësi të programit të zgjedhur. Një koordinim i saktë i kimisë, fortësisë së ujit dhe programit të larjes duhet të kryhet së bashku me konsulentët specialistë të kompanive të pastrimit dhe larjes. Bordet e informacionit e bëjnë më të lehtë për punonjësit që të zgjedhin programin e duhur.

Furnizimi i komponentëve individual të detergjentit në programin e larjes kontrollohet plotësisht automatikisht nga kompjuteri i dozimit. Në këtë mënyrë kemi siguri maksimale në aplikim dhe funksionim të përshtatshëm dhe të garantuar. Përveç kësaj, kjo teknologji parandalon mbetjet e panevojshme të detergjentit në lavanderi dhe ujëra të ndotur.

Përparësitë e programit të kompjuterizuar:

- dozë e përpiktë sipas programit;
- konsumi ekonomik i pastruesve;
- trajtimi i lehtë;
- nuk bëhet mbushja e kontejnerëve të detergjentit;
- ndikim më i ulët mjedisor;
- konsumi i kontrolluar i detergjentit dhe kontroll i koston.



1.13 Zbatimi i rregullave të higjienës, i mbrojtjes në punë dhe i ruajtjes së mjedisit në vendin e punës

1.13.1 Si i klasifikojmë rreziqet në punë?


- **Fizike:** në vende të ndryshme pune, ne mund të dëmtohem nga procese dhe makineri të ndryshme, nga pluhurat toksike, zhurmat, vibracionet, ndriçimi jo i përshtatshëm, rrezatimet etj.
- **Kimike:** substanca të ndryshme që lëshohen në vendin e punës.
- **Biologjike:** shumë mikroorganizma që qarkullojnë në vendin e punës.
- **Psiko-sociale:** janë po aq të rrezikshme sa rreziqet e tjera më lart. Por rrallë konsiderohen si dëmtues të shëndetit. Nivele të larta të stresit në punë mund të çojnë në dobësim të sistemit imunitar, probleme me zemrën, hipertensionin, ulcera në stomak, depresion etj.

Pyetje: Si ndikojnë në shëndetin tuaj marrëdhëniet jo të mira me shefin, kolegët, fyerjet, ofendimet, thashethemet në punë, dhuna verbale, ngacmimet seksuale, pasiguria, përgjegjësitë e mëdha, intensiteti i madh i punës, pakënaqësia nga puna etj.?

1.13.2 Cilat janë rreziqet?

- Zjarri – shkaktohet nga mbeturina cigaresh, defekte të rrjetit elektrik, mbingrohje të aparaturave të ndryshme, reaksione kimike ose zjarrvënie të qëllimshme.
- Elektriciteti – padituria, pakujdesia dhe indiferenca ndaj rrezikut.
- Rrëshqitjet, pengimet dhe rrëzimet – veçanërisht në industrinë e shërbimit.
- Rreziqet nga substancat kimike.
- Hapësirat e kufizuara.

Veprimtari praktike: Duke tekstualizuar figurat e mësipërme, konkretizoni mënyrat e shmangies së këtyre rreziqeve.



Udhëzues pune

RM 1 Nxënësi/ja përdor mjetet, pajisjet dhe detergjentët në lavanderi

1. Vishni uniformën, laj duart, vendos dorashkat.
2. Sistemoni detergjentët në raftet e magazinës sipas llojit dhe përdorimit.
3. Përdorni makinën larëse sipas udhëzimeve të manualit.
4. Përdorni makinën tharëse sipas udhëzimeve të manualit.
5. Përdorni hekurin e dorës sipas udhëzuesit të manualit.
6. Përdorni rulin hekurosës sipas manualit të përdorimit.
7. Përdorni sipas standardit dezinfektuesit e makinerisë larëse dhe tharëse.
8. Përdorni sipas standardit dezinfektuesit gjatë procesit të larjes.
9. Përdorni detergjentët larës sipas funksionit (fortësisë të detergjentit).

10. Përdorni detergjentët larës sipas ngjyrës dhe përbërjes së materialit.
11. Përdorni solucionet për heqjen e njollave.
12. Përcaktoni dozimin e detergjenteve sipas llojit, peshës dhe shkallës së pastërtisë së rrobave.
13. Zbatoni rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në vendin e punës.


Listë kontrolli

RM 1 Nxënësi/ja përdor mjetet, pajisjet dhe detergjentët në lavanderi

Nr.	Kompetencat	Pikët max	Pikët fituara	Nota
1	Veshja e uniformës së pastër dhe të rregullt në vendin e punës.			
2	Larja e duarve dhe vendosja e dorashkave.			
3	Sistemimi i detergjenteve nëpër rafte.			
4	Përdorimi i makinës larëse sipas manualit.			
5	Përdorimi i makinës tharëse sipas manualit.			
6	Përdorimi i hekurit të dorës dhe rulit hekurosës sipas manualit.			
7	Dezinfektimi i makinerisë dhe dezinfektimi gjatë procesit të larjes.			
8	Përdorimi detergjenteve larës sipas funksionit (fortësisë të detergjentit).			
9	Përdorimi i detergjenteve larës sipas ngjyrës dhe përbërjes së materialit.			
10	Përdorimi i solutioneve për heqjen e njollave.			
11	Përcaktimi i dozimin e detergjenteve sipas llojit, peshës dhe shkallës së pastërtisë së rrobave.			
12	Zbatimi i rregullave të higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në vendin e punës.			
	Totali i pikëve			

REZULTATI MËSIMOR NR.2

NXËNËSI/JA KRYEN PROCESET PARAPËRGATITORE PËR PASTRIMIN E TUALETIT DHE DHOMËS NË HOTEL



2.1 Veshja e uniformës në vendin e punës

Punonjësi i katit ose e mjediseve të përbashkëta sapo arrin në hotel, shkon në dhomën e veshjes dhe vesh uniformën dhe këpucët mbrojtëse për të filluar punën. Uniforma si në çdo post pune dhe në hotel duhet të jetë e pastër, e hekurosur, e mirëmbajtur. Gjithashtu, në pjesën e përparme është e ngjitur emri i hotelit dhe emri i puninjësit.



2.1.1 Punonjësi/ja i pastrimit

Punonjësit e pastrimit të dhomave luajnë një rol kryesor në imazhin e punëdhënësit të tyre. Edhe pse me natyrë femërore kjo detyrë është e hapur edhe për burrat. Çdo mëngjes pastruesja e dhomës ka për mision të rinovojë dhomat e hotelit të përshkruara brenda orarit të saj të punës. Ajo është gjithashtu e ngarkuar të plotësojë dhomat me të linjta. Rrallë, në funksion të organizimit të punës në hotel, ajo bën shërbimin në dhomë të mëngjesit ose thjesht shtrimin e bufesë.

2.1.2 Roli i punonjësit të pastrimit në dhoma

Ky rol mund të ndryshojë në funksion të hoteleve. Nën drejtimin e kujdestares së katit, ajo kryen detyra të përsëritshme. Çdo mëngjes, ajo duhet të:

- Veshë uniformën e punës. Uniforma e punës në hotele të ndryshme është e ndryshme, për sa i përket ngjyrës, tekstilit të përdorur, stilit të qepjes, shenjës dalluese të hotelit etj. Pavarësisht shumëllojshmërisë, uniforma duhet të përbëhet nga bluza ose përparësja e pastër, e hekurosur, dorezat e punës sipas llojit të punës, këpucët e përshtatshme për të ruajtur këmbët nga qëndrimi shumë orë në këmbë, të jenë të ajrosura dhe të mbrojtura nga djersa, gjithashtu të jenë të pajisura nga poshtë me shtresë kundër rrëshqitjeve.
- Ndërrojnë çarçafët dhe rregullojnë krevatet.
- Ndërrojnë peshqirët dhe mantelet e banjës dhe të dërgojë të palarat në lavanderi.

- Plotësojë nëse është e nevojshme produktet e konsumit (sapun, shampo, mini bar).
- Realizojë pastrimin e plotë të dhomave, nga dyshemeja tek sanitaret.
- Marrë pjesë në shërbimin e mëngjesit në dhomë ose të shtrimit të bufeve.
- Sigurojë pastrimin e mjediseve të përbashkëta nëse detyra është e përshkruar në planifikimin ditor.

2.1.3 Mënyra për tu bërë punonjës/e pastrimi për hotelet

Punonjësit e pastrimit të dhomave realizojnë çdo ditë pastrimin në një numri të caktuar dhomash të përshkruara në planifikimin e tyre ditor dhe gjithçka në një kohë të limituar. Ata duhet të jenë të organizuar për të menaxhuar sa më mirë kohën e tyre të punës dhe sidomos të veprojnë me efikasitet dhe shpejtësi.


Dhoma e hotelit është një vend intim për klientët. Prandaj, pastruesit duhet të jenë të matur për të mbrojtur jetën private të personave që u shërbejnë.

Përveç kësaj, punëmarrësit bëjnë kujdes duke angazhuar persona të ndershëm dhe të kualifikuar, për të mos ta parë imazhin e hotelit të tyre të shkatërruar nga vjedhjet e përsëritura të sendeve personale. Gabimi më i vogël në këtë fushë mund të ketë pasoja të rënda për karrierën e punonjësit të pastrimit.

Me pak fjalë, profesioni i pastrueses është i testuar:

- ndërmjet intensitetit të ritmit të punës;
- qëndrimit të vazhdueshëm në këmbë;
- ngritjes së peshave të rënda.

Kandidatët për këtë punë duhet të gëzojnë shëndet shumë të mirë fizik.



2.1.4 Karriera dhe mundësitë e përmirësimit

Profesioni i punonjësit të pastrimit të dhomave nuk kërkon kualifikime të veçanta. Punëmarrësit përdorin shumë lehtë kandidatë pa diplomë dhe pa eksperiencë, pasi sektori i shërbimeve të pastrimit vuan nga mungesa e fuqisë punëtore sidomos në qytet e mëdha.

Pas disa vitesh eksperiencë, një pastruese dhome mund të ngrihet në përgjegjësi dhe të marrë postin e përgjegjëses së katit. Me një trajnim plotësues, ajo mund të bëhet guvernante e përgjithshme e kateve duke përfituar njëkohësisht ngritje rroge.

2.1.5 Trajnimet e nevojshme

Profesioni i punonjësit të pastrimit është lehtësisht i arritshëm pa diplomë. Por ka megjithatë trajnime që përgatisin kandidatët për këtë profesion. Këto trajnime mund të jenë mbi mirëmbajtjen dhe higjienën e ambienteve, shërbimin e pastrimit në dhoma dhe mjediset e përbashkëta, përdorimi i detergjenteve të rinj, kualifikimi profesional me specialitet nëpunësin e kateve etj..

Këto trajnime të larmishme lejojnë evoluimin e shpejtë të karrierës. Ato nuk janë në asnjë rast të domosdoshme për një punë fillestare. Motivimi ngelet elementi kryesor mbi të cilin mbështeten rekrutuesit gjatë intervistës së punës. Institucionet e luksit ndonjëherë mund të kenë një sy më të kujdesshëm për sa i përket eksperiencës së kandidatëve.

Përballur me një mangësi të theksuar të fuqisë punëtore, sektori hotelier është në kërkim të vazhdueshëm të pastrueseve të dhomave. Qytetet e mëdha dhe zonat turistike janë më të prekura nga kjo situatë. Vështirësia qëndron tek puna e vështirë, oraret e shkëputura por gjithashtu edhe pagat globalisht jo shumë tërheqëse.

Si rezultat, nëse kandidatja është e lidhur me sektorin hotelier, ajo mund ta ushtrojë profesionin e saj pranë institucioneve të tjera të mikpritjes kolektive. Qendrat spitalore, shtëpitë e pensionistëve ose edhe konviktet janë gjithashtu ofruesit të mëdhenj pune edhe pse këto institucione kanë tendencë ta delegojnë misionin e rekrutimit në punë tek shoqëritë kontraktuese.

2.2 Përzgjedhja e mjeteve të nevojshme të punës për shërbimin e pastrimit në dhomë

- Veshja e uniformës së punës.
- Vendosja e panelit të verdhe (kujdes nga rrëshqitja).
- Larja e duarve me kujdes para vendosjes së dorashkave.
- Përgatitja e solucioneve larës për pajisjet sanitare pasi është lexuar etiketa e masës dhe përdorimit të tyre.
- Vendoset koshi i pastër për peshqirët dhe biankeritë e papastra.
- Vendoset koshi i pastër për largimin e mbeturinave.
- Bëhet përzgjedhja e mjeteve të punës: dorezave, pecetave, sfungjerëve, tharëses, kovës, parketezës për larjen e pllakave etj.



Veprimtari praktike 1

Përzgjidhni mjetet e punës për pastrimin e tualetit dhe banjës.



2.3 Përgatitja e karrocës së pastrimit sipas planit të higjienës (pastrimit të dhomave)

2.3.1 Sistemimi në karrocë i solucioneve të pastrimit, furçave, leckave të pastrimit sipas rregullit

Karroca shërben për një zhvillim të lehtë dhe pa probleme të shërbimit në dhomë. Ajo duhet të jetë në madhësi të mjaftueshme për të nxënë biankeritë për 25 krevate me të gjitha pjesët përbërëse, por edhe aq e vogël sa të përshtatet në ashensor. Thesi i vogël për teshat e papastra dhe ai tjetri i mbeturinave mund të ndërrohen pa mundim. Rrotat plastike në qoshet e jashtme të saj pengojnë dëmtimet nëpër dyer dhe mure.



Në hoteleri, karroca që përdor punonjësi i pastrimit të dhomës është një karrocë me disa kate që lejon radhitjen e të bardhave të pastra, të pistat, produktet e mikpritjes, etj. Pastërtia dhe rregulli i karrocës janë primare në kuptimin që prezanton imazhin e punonjësit po ashtu edhe imazhin e hotelit. Për më shumë, avantazhi e një karroce të sistemuar mire është fitim kohe për punonjësin duke lehtësuar lëvizjet e saj në dhomë.

Me të kaluar në postin e punës, punonjësi i pastrimit ngarkon karrocën e saj me të bardhat e pastra të nevojshme, të parashikuara në bazë të numrit të dhomave duke shtuar disa kite çarçafësh suplementarë për të shmangur rastet e ndonjë çarçafi me njolla ose të dëmtuar gjatë larjes. Në fund të shërbimit, karroca duhet të jetë plotësisht e zbrazur dhe e pastruar, të bardhat e pista duhet të jenë vendosur në dhomën e posaçme, dhe koshat e mbeturinave të boshatisur.

2.3.2 Vendosja dhe sistemimi i mjeteve të pastrimit në karrocën e shërbimit

Përpara se të niset për në kate, punonjësja e pastrimit të dhomave duhet të sigurohet të ketë të gjitha mjetet e nevojshme për të realizuar detyrën e saj pa humbur kohë duke bërë ece jake të panevojshme.

Detergjentët e pastrimi me ngjyra të ndryshme për të evituar kontaminimet e kryqëzuara. Hotele të ndryshme, kanë kode ngjyrash të ndryshme. Nuk ka rregulla të përcaktuara. Në disa vende p.sh. shumica e hoteleve përdorin ngjyrën e kuqe për të pastruar WC dhe urinoret e burrave.

2.4 Përzgjedhja e solucionet të pastrimit sipas standardit

2.4.1 Produktet e larjes

- Detergjenti asnjans: përdoret për larjen e të gjitha sipërfaqeve të dhomave.
- Detergjent dezinfektues aromatik: përdoret për larjen e përditshme të banjës, koha e veprimit të produktit duhet të jetë 12 minuta për të arritur objektivin e tij dezinfektues.
- Xheli gërryes: i quajtur ndryshe xhel pastrues ka për qëllim të eliminoj shtresën e pislëkut në pjesën e tualetit.
- Aromatizues dhomë: shpërndahet në dhomë në formën e sprajit në fund të shërbimit për ti dhënë ndjesinë e freskisë dhe pastërtisë dhomës.
- Uthull e bardhë: në hoteleri ky produkt është mirë të zëvendësoj detergjentin anti-kalkar. Ai përdoret zakonisht për rubinetat, avantazhi është që uthulla është pak më agresive mbi kromin dhe largon kalkaret e vjetra.
- Ajax për xhamat: përdoret për pastrimin e xhamave të dritareve, të dyerve të ballkoneve dhe pasqyrave. Me raste, përdoret edhe për shkëlqimin e pllakave të banjës pas larjes me ujë të rrjedhshëm. Për ruajtjen e mjedisit dhe sidomos të shëndetit, në ditët e sotme, industria e shërbimit ka filluar përdor vettex me ujë për pastrimin e sipërfaqeve të xhamta.

Veprimtari praktike: Përdorni solucionet e figurës së mësipërme duke demonstruar përdorimin e tyre sipas ngjyrave.



2.4.2 Hollimi produkteve të pastrimit

Hollimi i keq i produkteve larës ka pasoja të pakëndshme. Mbidoza nuk është asnjëherë një garanci për efikasitet. Në një produkt mbi dozë, përbërësit aktiv tërheqin njëri tjetrin dhe nuk veprojnë më. Produkti e humbet efikasitetin dhe sipërfaqet duken të papastra dhe ngjatin. Në përgjithësi, prodhuesit rekomandojnë një hollim midis 12% dhe 5%. Sigurisht, duhet ti referoheni etiketës së produktit për të mësuar dozën e saktë.

2.5 Sistemimi në karrocë i solucioneve të pastrimit, furçave, leckave të pastrimit sipas rregullit

Materialet dhe solucionet e pastrimit vendosen në një kuti të hapur dore e cila vendoset poshtë qeses së mbeturinave në karrocën e shërbimit. Duhet të tregohet kujdes që ambalazhi i solucioneve të mos ketë rrjedhje dhe të jenë të mbyllura mirë.

2.6 Sistemimi i të linjtave të pastra sipas rregullit

Kategoria e një hoteli është e lidhur me gjendjen e rrobave. Të linjtat e dhomës dhe banjës, të bardhat e dhomës në hoteleri përbëhen nga çarçafët, kuvertat, këllëfët e jastëkëve, jorganët etj. Shpesh një jorgan- zëvendëson konceptin çarçaf/kuvertë. Në shumë hotele, lavanteritë i furnizojnë hotelet me të linjtat në formën e një kiti (kompleti) të mbështjella me një qese plastike ku janë përfshirë edhe peshqirët. Kjo procedurë i siguron një logjistikë më praktike dhe një përdorim më të thjeshtë punonjësit të pastrimit të dhomave.



Pastërtia në hotele është në plan të parë dhe shumë e nevojshme. Shenja e parë dalluese e pastërtisë janë të linjtat e lara dhe të sistemuara sipas rregullit dhe standardeve në lavanderi, magazinë të kateve, në raftet përkatëse. Punonjësi i pastrimit të dhomave është përgjegjës që nga sistemimi në karrocën e punës, seleksionimi e të linjtat të pastra dhe të padëmtuara, e deri tek shtrimi i krevateve.

Veprimtari praktike: Sistemoni në karrocën e punës të linjtat për 10 dhoma (çarçafë, këllëf dhe peshqirë).



2.7 Vendosja e qeses për të linjëtat e përdorur sipas rregullit

Karroca e pastrimit ka një vend të posaçëm për të vendosur qesen e të linjtave të përdorura, zakonisht në një krah të karrocës vendoset qesja për mbeturinat dhe në krahun tjetër qesja e biankerisë së përdorur. Ajo duhet të ndërrohet në çdo së përgatitje të karrocës së shërbimit.

2.8 Sistemimi i artikujve të përdorimit (setit personal) të klientit sipas rregullit

Seti personal i klientit është një produkt shtesë i viteve të fundit në hotele i konsideruar si element promovimi dhe përkujdesje ndaj klientit. Ky set krijon tek klienti përkëdhelje dhe e bën atë të ndihet i rëndësishëm.

Rreth viteve 60, kur hotelet morën formën e tyre të plotë dhe konkurrenca filloi ti bënte pronarët e hoteleve më kërkuar në tërheqjen e klientëve cilësorë, përveç të tjerash, u krijua nevoja e elementëve të luksit dhe të kënaqjes shpirtërore të klientëve. Tashmë hotelet nuk ishin më vende për të kaluar natën, por edhe vende pushimi, argëtimi etj.

Një nga këta elementë të përkëdheljes dhe kënaqësisë së klientit ishte edhe seti personal që në ditët e sotme ka marrë emrin produkte të mikpritjes.

2.8.1 Produktet e mikpritjes

Produktet e mikpritjes janë produkte që i ofrohen klientit nga hoteli në dhomë ose në tualet. Këto produkte i lejojnë hotelit të bëjë diferencimin dhe ti ofrojnë një shenjë vëmendje speciale klientëve të tij.

Më poshtë do të gjeni të ilustruar me figura disa produkte.

- sapun;
- shampo për flokët;
- shampo për trupin;
- aromat;
- solucione hidratuese;
- seti i rruajtjes;
- seti dentar;
- seti i qepjes;
- kapuç dushi;
- krehër;
- sfungjer për këpucë etj.

Veprimtari praktike: Duke vëzhguar figurat, emërtoni produktet e mikpritjes dhe sistemojini në karrocën e punës.



2.8.2 Tabakaja aristokrate

Kjo lloj tabakaje mund të gjendet edhe në dhoma. Në këtë rast quhet tabakaja aristokrate.

Pas një udhëtimi të lodhshëm ose në orë të vona të mbrëmjes, ose pas disa ore pune në kompjuter ke dëshirë për një moment shp lodhjeje. Këtë dëshirë ta plotëson pa lodhje dhe shpenzime tabakaja aristokrate.

Madhësia, numri, prezantimi dhe cilësia e produkteve, pra kosto e tyre do të jenë proporcionale me çmimin e dhomës dhe kategorinë e hotelit. Në disa raste këto produkte janë më të rëndësishme kur u adresohen personave VIP. Këtu mund të kemi produkte shtesë si parfume, tufa me lule etj.



Veprimtari praktike: Duke vëzhguar ilustrimet, listoni produktet e tabakasë aristokrate dhe sistemojini në karrocën e punës (mbajtësen e çajit, kafetieren, filxhanët e kafes dhe çajit, flakon e kafes dhe çajit etj.).v

2.8.3 Qëllimi i setit personal

- Shton komfortin e klientit (duke e ndihmuar të udhëtojnë me bagazh të lehtë dhe mbështetet në këto produkte për tualetin e tij).
- Konsiderohen si dhurata të vogla të pritura këndshëm nga klienti dhe që mund ti fut në çantë si kujtim ose tua japë si kujtime të vogla të afërmeve.
- Përfiton besnikërinë e klientelës. Tashmë është kthyer në një shërbim shtesë për të cilin hotelierët tregojnë një kujdes të veçantë. Klienti do të rivijë sepse përveç cilësisë është dhe seti i vogël që i jep kënaqësi.
- Shërben si mbështetje reklame (emri i hotelit në produkt).
- Preferenca e produkteve bimorë kontribuon në ekologji. Shumë klientë në ditët tona bëjnë kujdes gjithnjë e më shumë për sa i përket zhvillimit të qëndrueshëm dhe ruajtjen e mjedisit duke evituar produktet kimike.
- Kostoja e tyre është e lartë. Pastruesja e dhomës kujdeset për produktet e pa hapura dhe i ripërdor.



2.9 Sistemimi i materialeve informative për klientin sipas rregullit

Materialet informative, shenjat dhe tabelat:

- etiketimi i çmimit të dhomave;
- njoftimi për sjellje ne rast zjarri;
- shenja mirësjelljeje “Mos shqetësoni”;
- informacioni mbi qytetin në forma të ndryshme, fletë palosje, broshura;
- guida me informacion artistik, kulturor dhe social;
- lista për shërbimet e luanterisë me çmimet përkatëse.

2.10 Përgatitja për përdorim e fshesës me korrent

Fshesa me korrent lejon pastrimin e thatë të moketeve në fund të detyrës. Kur fillon dita e punës, pastruesja duhet të kontrollojë gjendjen e qeses së filtrit, në mënyrë që ta ndërrojë nëse është e domosdoshme, para se të ngjitet në kate. Në fund të punës, fshesa me korrent do të pastrohet dhe sistemuar korrektësisht.

Fshesa trapeze përdoret për fshirjen me leckë të lagur të dyshemeve të lëmuara dhe të thata, parket p.sh.

Lecka e larjes përdoret për larjen e sipërfaqeve të banjave dhe tualeteve.

Veprimtari praktike: Demonstroni përdorimin e fshesës me korrent dhe fshesave trapezoid ose parketëzave.



2.11 Zbatimi i planit të pastrimit të dhomave

Organizimi i shërbimit të pastrimit:

1. Punët përgatitore:

- evidentimi i nevojave për shërbimin e pastrimit;
- bashkëpunimi me receptionin dhe lavanterinë;
- këshillimi dhe bashkëpunimi me përgjegjësen e katit;
- sistemimi në karrocë i solucioneve të pastrimit, furçave, leckave të pastrimit sipas rregullit.

2. Kryerja e veprimtarisë së pastrimit: pastrimi i tualetit dhe dhomës së klientit.

3. Punët paspërgatitore: pastrimi i mjeteve dhe pajisjeve, boshatisje dhe ndarje e mbeturinave, pastrimi i zyrës.



2.12 Zbatimi i rregullave të higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në vendin e punës

Në çdo moment të ditës dhe në çdo veprimtari praktike, punonjësi i pastrimit të dhomave në hotel është i ekspozuar ndaj rreziqeve dhe risqeve të cilat mund të dëmtojnë shëndetin dhe jetën e punonjësit, por edhe mbarëvajtjen e punës. Rreziqet e rrëzimit, të rrëshqitjes, pengimit janë domosdoshmërisht të kontrollueshme dhe më pak të dëmshme, nëse do ti krahasonim me risqet elektrike dhe kimike, të cilat zakonisht nuk japin mundësi të dytë.

Rreziqet kimike përfaqësojnë 15% të aksidenteve profesionale dhe e kanë origjinën në keq përdorimin e produkteve.

Rrugët e kontaktit me organizmin janë:

- duart;
- sytë;
- hunda;
- goja;
- disa produkte janë të prirur të provokojnë alergji;
- alergji në lëkurë;
- alergji në rrugët e frymëmarrjes;
- aksidentet pulmonare dhe intoksifikimet.

Në këto kushte, shumë aktorë janë të përfshirë në ruajtjen dhe përkujdesin ndaj jetës së punonjësit të pastrimit dhe ambientit të punës. Përgjegjësia më e madhe bie përsëri mbi punonjësin, të cilit i bie si detyrë të jetë i kujdesshëm dhe të njohë detergjentët e pastrimit, mënyrat e ruajtjes nga aksidentet dhe dhënia e ndihmës së parë.

Veprimtari praktike: Demonstroni dhe praktikoni dhënien e ndihmës së parë në rastin derdhjes së solucioneve në pjesët e trupit.

Udhëzues pune

RM 2 Nxënësi/ja kryen proceset parapërgatitore për pastrimin e tualetit dhe dhomës në hotel

- Vishni uniformën, laj duart dhe vendos dorezat në vendin e punës.
- Përzgjidhni mjetet e nevojshme të punës për shërbimin e pastrimit në dhomë.
- Përgatisni karrocën e pastrimit sipas planit të higjienës (pastrimit të dhomave).
- Përzgjidhni sipas standardit solucionet e pastrimit.
- Sistemoni në karrocë solucionet e pastrimit, furçat, lecat e pastrimit, qese për biankerinë e përdorur sipas rregullit.
- Sistemoni të linjtat e pastër sipas rregullit.
- Sistemoni artikujt e përdorimit (setit personal) dhe materialet informative për klientin sipas rregullit.

- Përgatisni për përdorim fshesën me korrent.
- Zbatoni planin e pastrimit të dhomave.
- Zbatoni rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në vendin e punës.

Listë kontrolli

RM 2 Nxënësi/ja kryen proceset parapërgatitore për pastrimin e tualetit dhe dhomës në hotel

Nr.	Kompetencat	Pikët max	Pikët fituara	Nota
1	Veshja e uniformës, larja e duarve dhe vendosja e dorezave në vendin e punës.			
2	Përzgjedhja e mjeteve të nevojshme të punës për shërbimin e pastrimit në dhomë.			
3	Përgatitja e karrocës së pastrimit sipas planit të higjienës (pastrimit të dhomave).			
4	Përzgjedhja sipas standardit e solucionëve të pastrimit.			
5	Sistemimi në karrocë i solucionëve të pastrimit, furçat, lekat e pastrimit, qese për të linjtat e përdorura sipas rregullit.			
6	Sistemimi i të linjtatave të pastra sipas rregullit.			
7	Sistemimi i artikujve të përdorimit (setit personal) dhe materialet informative për klientin sipas rregullit.			
8	Përgatitja për përdorim e fshesës me korrent.			
9	Zbatimi i planit të pastrimit të dhomave.			
10	Zbatimi i rregullave të higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në vendin e punës.			
	Totali i pikëve			

REZULTATI MËSIMOR NR.3

NXËNËSI/JA PASTRON TUALETIN DHE DHOMËN E HOTELIT



3.1 Veshja dhe uniforma në vendin e punës

Trajtuar në RM2.

3.2 Pastrimi i tualetit në dhomën e hotelit

3.2.1 Puna përgatitore


- Vishet uniforma e pastër dhe këpucët mbrojtëse jo të rrëshqitshme.
- Përgatiten mjetet pastruese duke përdorur ngjyrat për të dalluar proceset e ndryshme që do ti shikojmë më poshtë



- Përzgjedhen produktet e pastrimit, solucionet e dezinfektimit, pastrimit, xheli i banjës, qeset, kova me dy ndarje për ujë me detergjent dhe ujë të pastër, fshesa e parketit.
- Bëhet sistemimi i tyre në karrocën e punës dhe përgatitja e ujit me detergjent dhe me ujë të pastër.
- Para fillimit të punës domosdoshmërisht të vendoset shenja dalluese për rrezik rrëshqitje. Të lahen duart dhe të vendosen dorashkat.
- Veshjet e papastrat futen në thesin e rrobave.
- Boshatisen dhe pastrohen kovat e mbeturinave.



- Tërhiqet kazani i ujit, hidhet xheli i pastrimi në WC dhe vendoset furça.




- Spërkaten pllakat murale, WC komplet nga jashtë, hapet kapaku dhe spërkatet gjithashtu me detergjent pastrues.
- Spërkaten me detergjent plakat murale mbi lavaman dhe lavamani komplet nga lart-poshtë.




3.2.2 Pastrimi i banjës dhe vaskës


- Lejoni të veprojnë detergjentët, ndërkohë që hidhni qesen e karrocës.
- Shpërlani me ujë të pastër dhe të rrjedhshëm plakat, WC dhe lavamanin.
- Me vettexin (detergjent) blu fshini në të thatë pjesën e ndriçimit dhe pasqyrën.
- Me vettexin (detergjent) e verdhë fshini pllakat porcelani, depozitat mbajtëse të solucionit të duarve, shpërndarësin e letrave, lavamanin, çelësat dhe prizat, konturet e dyerve.
- Vazhdoni me vettexin e verdhë dhe fshini koshin e letrave nga jashtë-brenda dhe vendosni qesen e bardhë.



- Lani me furçë tualetin nga brenda, tërhiqni ujin dhe shpërlani furçën, me vettexin rozë fshini WC nga lartë-poshtë.



- Pastroni portën me mekanizmin e larjes së xhamave nga poshtë lartë dhe fshini anët me një peshqir.



- Spërkasni vettexin e bardhë me dezinfektantë dhe fshini pikat e kontaktit të duarve.
- Fshini dyshe-menë dhe lajeni.



Puna në vaskë:

- Përgatisni mbajtësen e sapunëve në vaskë.
- Shpërlani me ujë të pastër pllakat dhe më pas fshijini.
- Jepini shkëlqim pajisjeve dhe mekanizmave përbërës të dushit.

Kujdes:

- Pastroni kullimet dhe derdhjet tek lavamani (sedimentet e papastërtive, qime etj.).
- Përdorni solucione larës që mbron mjedisin.

3.2.3 Kontrolli i funksionimit të pajisjeve dhe kompletimi me materiale sipas inventarit



- Verifikoni dhe ndërroni materialet e konsumit si letra e banjës, letra e duarve dhe solucionet.



- Vendosni sapunët në mbajtësen e tyre.
- Shtroni dhe ndeni sipas përdorimit veshjet dhe artikuj të përdorimit.



- Shtroni tapetin i banjës.
- Bëni një auto kontroll të imtësishëm si me lupë (pasqyra, ndriçimi, pastërtia e pajisjeve sanitare dhe rubineteve, pastërtia dhe dispozicioni i peshqirëve, produkteve të pritjes, dysheme dhe plintusave).
- Pas mbarimit hidhni dorashkat dhe lani duart.
- Fikni drita.

Veprimtari praktike:

Pastroni tualetin e hotelit duke ndjekur hapat e procedurës së punës.

3.3 Pastrimi i dhomës së hotelit sipas radhës së punës dhe proceset përkatëse

3.3.1 Verifikimi i gjendjes së dhomave të hotelit

Bëhet kontrolli në të majtë dhe në të djathtë duke mbajtur shënim punët që duhen bërë.

Procedurat e kontrollit të dhomës:

- **Nga jashtë dhomës** (dera nga jashtë, doreza).
- **Brenda dhomës** (aromat, dera nga brenda, doreza, tabelat me shënime).
- **Kontrolli i dhomës** (pasqyra dhe korniza, dekorimet dhe tablotë me korniza, pajisjet elektrike, dollapi me jastëkët dhe kuvertat shtesë, portemantoja, komodina dhe sirtarë brenda dhe jashtë, funksionimi i llapave dhe abazhurëve, pastërtia e çarçafëve, kuvertave, shtrimi, dyshemeja, pluhurat e mobileve, blindueset e mureve, funksionimi i televizorit dhe telekomandës, mini bari).
- **Duke dalë nga dhoma** (kontrolli i klimatizimit të dhomës).



3.3.2 Procedurat dhe kërkesat për mirëmbajtjen e dhomave të hotelit

Për pastrimin dhe mirëmbajtjen e dhomave janë me rëndësi 4 pika:

1. pastrimi dhe mirëmbajtja e dhomave të zëna;
2. pastrimi dhe mirëmbajtja e dhomave të porsa lëna;
3. mirëmbajtja e dhomave në shërbim të mëvonshëm;
4. përdorimi i solucioneve të pastrimit që nuk dëmtojnë mjedisin (p.sh, sapunë, sodë, uthull etj.).

3.4 Pastrimi i dhomave të hotelit

3.4.1 Hyrja në dhomë

Dhoma është sfera e klientit që duhet respektuar rreptësisht. Tabela e varur jashtë “*Mos shqetësoni*” nuk duhet të nënvlerësohet. Edhe pa këtë tabelë, para hyrjes në dhomë, trokitet dhe sipas rrethanave disa herë. Nëse klienti është i pranishëm në dhomë, kujdestarja e dhomës duhet të pyesë me mirësjellje, se kur mund të përkujdeset për dhomën.



3.4.2 Trajtimi i objekteve private

Objektet private duhet të:


- vihen mënjane si në dhome ashtu dhe në banjë;
- trajtohen me kujdes;
- mos hedhje e asgjëje;
- rivendose në vendin e fillimit.

3.4.3 Radha ndjekëse e pastrimit të dhomave

1. Në përgjithësi, duhen pastruar dhomat e klientëve të pranishëm para dhomave të klientëve të porsa larguar.
2. Klientët e rinj vijnë pothuajse pasdite.
3. Klientët e përhershëm duhet të kthehen më herët në dhomën e tyre.
4. Klientët e porsa mbërritur nuk mund të lihen të presin gjatë për të hyrë në dhomën e tyre.

3.4.4 Sistemimi i dhomave të hotelit

- **Rregullimi i krevateve:** tërhiqet dhe drejtohet mbajtësja e dyshekut, shtrohen çarçafët, shtrihen batanijet, shtrohet batanija e përditshme.



- **Pastrimi i pluhurit dhe i papastërtive:** pastrimi i telefonit, komodinës, llambës së tavolinës, mobileve, pikturave dhe tavolinës.
- **Pastrimi i dyshemesë:** fshirje me fshesë me korrent dhe larja me parketezën e lagur. Bëni kujdes në përgatitjen e kovës së larjes. E mbushim kovën me 4 l ujë dhe përdorim masën e caktuar të detergjentit pasi kemi lexuar me kujdes etiketën.
- **Vendosja e objekteve të klientit:** artikujt e klientit që përgjigjen listës, vendosen mbi komodinë, tavolinën e shkrimit, tavolinën rrumbullake.
- **Kontrolli:** i funksionimit të pajisjeve elektrike si prizat, dritat, kondicioneri, sistemi ngrohës, abazhurët, kafetiera.
- **Kontrolli dhe plotësimi:** i mini barit me produktet sipas inventarit të dhomës.



- **Kontrolli:** i funksionimit të kasafortës.
- **Kontrolli:** i funksionimit të telefonit dhe televizorit.
- **Mbylljen dritaret:** tërhiqen perdet dhe sistemohen.

Disa neglizhenca në pastrimin e dhomës së klientit

- hapësira ndërmjet dyshekut dhe mbulesës mbrojtëse së dyshekut si dhe pluhura dhe grimca ushqimore;
- pjesa e brendshme e sirtarëve dhe dollapi;
- sipërfaqet pas abazhurit dhe aksesoreve të tjerë mbi tavolinë;
- pjesa e sipërme e pasqyrës, pikturave;

- telefoni pjesa e receptorit dhe butonat;
- pjesa e sipërme e kasës së derës dhe e derës;
- pjesa e sipërme e radiatorit apo kondicionerit dhe pjesa fryrëse;
- pjesa e tapetit apo dyshemesë pas pajisjeve të dhomës si tavolinë, komodinë, dollap etj.;
- jastëku, këllëfi jastëkut duhet të jenë pa rrudha, pa fije floku dhe duhet të kenë aromë të mirë;
- dhoma në përgjithësi duhet të mbaje aromë të mirë;
- hapësira afër dhe poshtë dushit mbledh papastërti dhe lagështirë;
- hapësira poshtë tualetit, lavamanit;
- rubineta e lavamanit dhe dushit;
- hapësira ku mbështetet rubineta e lavamanit dhe dushit;
- kapaku i tualeti;
- pjesa pas pasqyrës në tualet;
- pjesa mbyllëse dhe filtra e rubinetës;
- aspiratori në dhomë apo tualet;
- kanatat e dyerve apo dritareve;
- perdet dhe pjesa e sipërme e kornizave.

3.5 Rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në vendin e punës

- Përzgjidhni solucione të padëmshme për njeriun dhe mjedisin.
- Vendosi shenja dalluese parandaluese.
- Parandaloni rrezikun e elektricitetit. Ekzistojnë dy lloje rreziqesh të lidhur me përdorimin e rrymës elektrike:
 - a) Kontakti direkt: prekja e një kabulli të dëmtuar ose një burimi rryme.
 - b) Kontakti indirekt: zona e zhveshur e kablot prek një pjesë metalike të aparatit që ju mbani në dorë.

Për të parandaluar këto rreziqe, është e domosdoshme të vëzhgoni ambientin në të cilin do të ekzekutoni lëvizjet e njëpasnjëshme, të mos tërhiqni asnjëherë kablot për të shkëputur nga prize një material elektrik.

- Menaxhoni stresin e punës që shkaktohet nga orët e gjata të punës dhe lodhja fizike.
- Krijoni marrëdhënie korrekte me kolegët e punës dhe eprorët.

Veprimtari praktike:

Demonstroni pastrimin e dhomës sipas hapave të mësipërm.



Udhëzues pune

RM 3 Nxënësi/ja pastron tualetin dhe dhomën e hotelit

- Vishni uniformën dhe vendosni dorezat sipas përdorimit për pastrimin e dhomës dhe tualetit.
- Ajrosni dhomën sipas rregullit.
- Pastroni dhe dezinfektoi sipas rregullit të WC dhe furçën e WC –së.
- Seleksiononi mbeturinat dhe pastroni koshin.
- Mblidhni dhe ndani peshqirët e papastër sipas përdorimit.
- Kontrolloni sipas rregullit funksionimin e pajisjeve në tualet dhe dhomë.
- Pastroni dhe dezinfektoni vaskën dhe pjatën e dushit.
- Pastroni sipas rregullit lavamanin dhe pasqyrën.
- Shkëlqeni pjesët më përbërje metalike.
- Pastroni dyshtemenë, pllakat, tapetin dhe dyert.
- Vendosni sipas rregullit peshqirët përkatës.
- Kompletioni tualetin me materialet sipas inventarit.
- Plotësoni tualetin me materialet e konsumit.
- Largoni çarçafët dhe këllëfët e përdorur dhe vendosni në qese biankeritë e përdorura sipas rregullit.
- Lani xhamat dhe pastroni mobilet e dhomës me solucionet përkatëse.
- Pastroni tapetin me fshesë me korrent.
- Kontrolloni funksionimin e pajisjeve të ndriçimit sipas rregullit.
- Kontrolloni dhe evidentoni rrobat e klientit për tu larë.
- Kontrolloni dhe plotësoni mini barin me produktet e konsumuara.
- Shtroni çarçafët dhe vendosë këllëfët sipas rregullit.
- Rregulloni krevatin dhe shtro mbulesat sipas standardit.
- Kompletioni dhomën sipas listës së inventarit.
- Zbatoni rregullat e higijenës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në vendin e punës.

Listë kontrolli

RM 3 Nxënësi/ja pastron tualetin dhe dhomën e hotelit

Nr.	Kompetencat	Pikët max	Pikët fituara	Nota
1	Veshja e uniformës dhe vendosja e dorezave sipas përdorimit për pastrimin e dhomës dhe tualetit.			
2	Ajrosja e dhomës sipas rregullit.			
3	Pastrimi dhe dezinfektimi sipas rregullit i WC dhe furçën e WC-së.			
4	Seleksionimi i mbeturinave dhe pastrimi i koshit.			
5	Mbledhja dhe ndarja e peshqirëve të papastër sipas përdorimit.			
6	Kontrolli sipas rregullit i funksionimit të pajisjeve në tualet dhe dhomë.			
7	Pastrimi dhe dezinfektimi i vaskës dhe pjatës së dushit.			
8	Pastrimi sipas rregullit i lavamanit dhe pasqyrës.			
9	Shkëlqimi i pjesëve me përbërje metalike.			
10	Pastrimi i dyshemesë, pllakave, tapetit dhe dyerve.			
11	Vendosja sipas rregullit i peshqirëve përkatës.			
12	Kompletimi i tualetit me materialet sipas inventarit.			
13	Plotësimi i tualetit me materialet e konsumit.			
14	Largimi i çarçafëve dhe këllëfëve të përdorur dhe vendosja në qese l biankerive të përdorura sipas rregullit.			
15	Larja e xhamave dhe pastrimi i mobilieve të dhomës me solucionet përkatëse.			
16	Pastrimi i tapetit me fshesë me korrent.			
17	Kontrolli i funksionimit të pajisjeve të ndriçimit sipas rregullit.			
18	Kontrolli dhe evidentimi i rrobave të klientit për tu larë.			

19	Kontrolli dhe plotësimi i mini barit me produktet e konsumuara.			
20	Shtrimi i çarçafëve dhe vendosja e këllëfëve sipas rregullit.			
21	Rregullimi i krevatit dhe shtrimi i mbulesave sipas standardit.			
22	Kompletimi i dhomës sipas listës së inventarit.			
23	Zbatimi i rregullave të higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në vendin e punës.			
	Totali i pikëve			

REZULTATI MËSIMOR NR.4

NXËNËSI/JA PASTRON MJEDISET E PËRBASHKËTA TË HOTELIT



Për të ruajtur një reputacion të mirë dhe për të mbajtur klientët, hotelet duhet gjithmonë të mbajnë një nivel të pastër të mjediseve të përbashkëta të hotelit, atje ku klientët kanë kontaktin e parë me hotelin dhe kjo gjë ndikon edhe në vazhdimësinë e qëndrimit të tyre të gëzueshëm dhe pa ankesa. Prandaj operacionet e pastrimit mendohen si një element themelor i imazhit të cilësisë së këtyre institucioneve publike.

Mjediset e përbashkëta publike janë:

- korridoret e hotelit;
- tualetet e përbashkëta;
- shkallët;
- holli i pritjes ku është vendosur dhe recepsioni;
- pishinat;
- sallat e konferencave;
- palestrat;
- verandat;
- zyrat e administratës.

Këto ambiente të përbashkëta kanë nevojë për pastrim dhe për mirëmbajtje. Për këtë arsye pastruesja ose pastruesi i hotelit është një punonjës jo pak i rëndësishëm. Përveç kompetencave që kemi cituar si pastrues dhome dhe kati, edhe në këtë sektor gruaja ose burri që do të ngarkohet kjo detyrë duhet të jenë të përgjegjshëm për rëndësinë e këtij procesi pune.

Disa nga fushat e punës janë:

- Pastrimi i dysHEMEVE të korridoreve, hapësirave të uljes dhe lobit.
- Aspirimi, dezinfektimi, aplikimi i detergjentit, grumbullimi i mbeturinave, lustrim, tharje.
- Dezinfektimin e pjesëve në kontakt me duart: butonat e ashensorit, dorezat e hyrjes kryesore, të tualeteve të përbashkëta, të makinës me pije dhe snacks etj.



Pastrimi jashtë hotelit

- Pastrimi i parqeve të makinave: aspirimi dhe pastrimi i terreneve.
- Mirëmbajtja e objekteve të plehrave.
- Mirëmbajtja e zonave të gjelbërta: bimët për ujitje dhe krasitje, dekorimi sezonal.
- Pastrimi i zonave të relaksimit: pishina, tarracë.



4.1 Veshja dhe uniforma në vendin e punës


Veshja e uniformës së punës është si më RM1



4.2 Përgatitja e mjeteve të punës për pastrimin e mjediseve të përbashkëta sipas rregullit

Puna fillon me:

1. larjen e duarve;
2. veshjen e dorashkave të punës;
3. përgatitja e kovës me ujë dhe detergjent;
4. përgatitja e karrocës së punës (detergjente, vettex me ngjyra për procese pune të ndryshme, letra higjienikë për tualete e përbashkëta, qese plastike për mbeturinat, doreza etj.) Përzgjedhja e mjeteve të pastrimit.



4.2.1 Vendosja e tabelave të mbrojtjes ndaj aksidenteve, incidenteve në mjediset e përbashkëta

Ashtu siç e shikoni dhe në figurë paneli i mbrojtjes është elementi i parë që vendoset para fillimit të pastrimit. Ai është i domosdoshëm për ruajtjen e klientëve nga rrëshqitjet, por edhe për sigurinë e punonjësve.

Largimi i mbeturinave dhe seleksionimi i mbetjeve sipas llojit. Punonjësi i pastrimit i përcaktuar në ditën e tij të punës për pastrimin e vendeve të përbashkëta, ka për detyrë të kontrollojë herë pas here mbeturinat në tualete, holl, korridore, zyra të administratës etj. Këtë detyrë ai e kryen në mënyre diskrete pa shqetësuar klientët dhe punonjësit e tjerë të hotelit.



4.3 Pastrimi dhe dezinfektimi i tualeteve dhe mjediseve të hotelit në çdo moment të ditës

Pastrimi i tualeteve dhe mjediseve të hotelit mund të jetë një detyrë shtesë e ditës së punonjësit, pasi ka mbaruar me sukses pastrimin e dhomave dhe katit. Pastrimi dhe dezinfektimi i tyre kalon në të njëjtat faza si dhe pastrimi i dhomës dhe tualetit të dhomës. Për pastrimin e ambienteve të përbashkëta bëhet përzgjedhja e mjeteve të punës që janë të përcaktuara për pastrimin e tyre. Këtu është i domosdoshëm pastrimi dhe kompletimi i herë pas herëshëm i tualetit me materiale konsumi.

Punonjësi i pastrimit lan hollin, ashensorin dhe shkallët e hotelit me leckë larëse dhe kovë ose me parketëzë sipas llojit, fshin me fshesë me korrent tapetet në holl ose në sallonet e vogla të kateve, fshin pluhurat në recepsion, vitrina, piktura etj., lan xhamat.



4.4 Pastrimi sipas rregullit në zyrat e administratës

Zyrat e administratës janë ambiente që nuk kanë lejueshmëri nga klienti. Pra, ato nuk ndoten shumë. Këto ambiente kanë nevojë të pastrohen në mëngjes para se të hyjë administrata, ose më mbrëmje kur largohen. Gjatë ditës mund të hiqen letrat, mbeturinat e ndryshme dhe fshihen pluhurat.

Veprimtari praktike:

Duke pasur parasysh udhëzuesin dhe materialet e mësipërme, pastroni, lani dezinfektoni ambiente e shkollës, si korridoret, banjat, sallën e mësuesve, drejtorinë etj.

4.5 Rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në vendin e punës

Trajtuar në RM1

Veprimtari praktike: Duke u mbështetur në materialet e të katër rezultateve mësimorë të modulit, krijoni situata të ndryshme me rreziqet në punë, masat paraprake dhe ndihma e parë.

Udhëzues pune

RM 4 Nxënësi/ja pastron mjediset e përbashkëta të hotelit

- Vishni uniformën dhe vendos dorezat sipas përdorimit në vendin e punës.
- Përgatisni mjetet e punës për pastrimin e mjediseve të përbashkëta të hotelit.
- Vendosni tabelat e mbrojtjes ndaj aksidenteve, incidenteve në mjediset e përbashkëta.
- Largoni dhe seleksiononi mbeturinat/ mbetjet sipas llojit.
- Pastroni dhe dezinfektoni sipas rregullit tualetet në mjediset e hotelit.
- Plotësoni tualetet me material konsumi.
- Lani hollin e hotelit sipas rregullit.
- Pastroni tapetet me fshesë me korrent.
- Pastroni dhe lani shkallët sipas rregullit.
- Fshini pluhurat në recepsion, vitrina, piktura etj.
- Pastroni sipas rregullit zyrat e administratës.
- Zbatoni rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në vendin e punës.

Listë kontrolli

RM 4 -Nxënësi/ja pastron mjediset e përbashkëta të hotelit

Nr.	Kompetencat	Pikët max	Pikët fituara	Nota
1	Veshja e uniformës dhe dorezave në vendin e punës.			
2	Përgatitja e mjeteve të punës për pastrimin e mjediseve të përbashkëta sipas rregullit.			
3	Vendosja e tabelave të mbrojtjes ndaj aksidenteve, incidenteve në mjediset e përbashkëta.			
4	Largimi dhe seleksionimi i mbeturinave/ mbetjeve sipas llojit.			
5	Pastrimi dhe dezinfektimi sipas rregullit i tualeteve në mjediset e hotelit (në çdo moment të ditës).			
6	Kompletimi sipas rregullit i tualetit me materiale konsumi.			
7	Larja sipas rregullit e hollit të hotelit.			
8	Pastrimi i tapeteve me fshesë me korrent sipas rregullit.			
9	Pastrimi dhe larja e shkallëve sipas rregullit.			
10	Fshirja e pluhurave në recepsion, vitrina, piktura etj.			
11	Pastrimi sipas rregullit i zyrave të administratës.			
12	Zbatimi i rregullave të higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në vendin e punës.			
	Totali i pikëve			

